



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:142620

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06383206

KPPP.nr. 701/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., me numër unik identifikues 810485864 dhe seli në Prishtinë, “Sheshi Nënë Tereza”, p.nr., kundër debitorëve: 1. “008” SH.P.K., me numër unik identifikues 811159616 dhe seli në Prishtinë; 2. Xh.V. me numër personal ... dhe adresë në Prishtinë; 3. “Villa 008” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811128083 dhe seli në Llapnasellë, dhe 4. E.B., me numër personal ... dhe adresë në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K, me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas propozimit të debitorëve të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 415/22, të lejuar me datë 23.06.2022, nga Përbaruesi Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë, me datë 31.10.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar propozimi i debitorëve 1. “008” SH.P.K.; 2. Xhavit Vllasaliu; 3. “Villa 008” Sh.P.K., dhe; 4. E.B., ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 415/22, të lejuar me datë 23.06.2022, nga Përbaruesi Privat Ilir Mulhaxha.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 415/22, i lejuar me datë 23.06.2022, nga Përbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., mbi bazën e dokumentit përbarimor Marrëveshjes mbi pengun e datës 28.08.2020, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë për biznes me numër 261944, e datës 28.08.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengut me R-20200903-

188, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 415/22, të datës 23.06.2022, për realizimin e borxhit ndaj debitorëve në vlerë prej EUR 39,450.67.

Debitorët, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se borxhi i pretenduar nga kreditori nuk ekziston dhe i njëjti nuk është i mbështetur në një dokument të besueshëm i cili do të vërtetonte ekzistimin e këtij borxhi. Më tej, ka theksuar se në propozimin për përmbartim nuk specifikohet se detyrimi është solidar dhe debitorët janë përgjegjës bashkërisht për borxhin, mirëpo të njëjtëve u është kërkuar pagesa e borxhit veç e veç për secilin. Ka shtuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 71 të LPP-së, duke i propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorëve, ndërsa urdhri për përmbartim të shfuqizohet, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej EUR 2,184.00, sipas tarifës së avokatëve.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorëve të paraqitura në prapësim nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së për ushtrimin e prapësimit. Më tej, ka theksuar se propozimi për përmbartim është iniciuar nga kreditori në përputhje me dispozitat e LPP-së, në bazë të dokumentit përmbartues, konkretisht kontratës së pengut e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut. Ndërsa, sa i përket pretendimit të debitorëve se të njëjtëve u është kërkuar pagesa e borxhit veç e veç për secilin është e pa bazuar, pasi që me propozimin për përmbartim është precizuar borxhi i tërësishëm në lartësi prej EUR 39,450.67 dhe se është kërkuar që borxhi të paguhet në tërësi nga të gjithë debitorët në përputhje me obligimet e tyre si palë të marrëveshjes kreditore. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorëve si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore

përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Gjykata duke vlerësuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Marrëveshjen mbi pengun me numër 261944, e datës 28.08.2020, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë për biznes me numër 261944, e datës 28.08.2020, gjeti se e njëjta është regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimin e pengut Nr. R-20200903-188, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 22 pika 1.7a dhe neni 27 të LPP-së, për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 701/23, datë 31.10.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.